



1894

135/4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr 574/1 Prot

Tiranë më 20 / 10 / 2021

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr 1672/1 prot datë 06.10.2021

Drejtuar: Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen

e të Dhënave Personale

Drejtorisë së Vlerësimit të Ankesave

Për dijeni: QENDRËS RES PUBLICA

TIRANË

I nderuar Z. Dervishi,

Në vijim të shkresës Tuaj nr 1672/1 prot datë 13.10.2021 hyrje me tonën nr 574 prot datë 14.10.2021 me objekt "Në lidhje me ankimin ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare" ju informojmë si vijon:

Autoriteti Publik në përgjigje të pyetjes së kërkuesit konkretisht "Sa ka kushtuar koncerti i Placido Domingo në Shqipëri në inagurimin e Teatrit të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor ("Rikonstruksioni- Hapja e TKOB" – Grand Gala datë 15.09.2021")? ka kthyer përgjigje duke ju referuar pyetjes konkrete që ai ka parashtruar duke e informuar me shkresën nr 539 prot datë 29.09.2021.

Sqarojmë se Autoriteti Publik ka organizuar një koncert në kuadër të inagurimit të rikonstruksionit të TKOBAP-së duke qënë edhe i ftuari Placido Domingo pjesë e këtij koncerti, si kundër të ftuarit e tjerë speciale. Koncerti nuk ka qene ekskluzivisht i Placido Domingos për të cilin ishte ndërtuar edhe pyetja nga kërkuesi mbi të cilën mori përgjigjen bazuar në kushtet e kontratës së nënshkruar midis palëve.

Në vijim, TKOBAP në kuadër të garantimit të transparencës së fondeve të Buxhetit të Shtetit dhe të interesit publik, ju informon se shpenzimet e koncertit "Grand Gala e Inagurimit të TKOBAP-së" janë në shumën 14.955.006 Lek

Për çdo komunikim tjetër me qëllim transparencën e aktivitetit tone jemi të hapur për dhenien e informacionit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORE E PËRGJITHSHME

ZANA CELA

Konceptoi: Juriste Migena Biba

Miratoi: Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
Aida GEGAJ

